



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Zyra e prokurimit në një (1) rast në dosjen e tenderit kishte specifikuar marken tregtare dhe emrin e prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë.
- A2 Mosrespektim i procedurave të prokurimit nga misionet diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës.
- A3 Mungesë e monitorimit dhe të dëshmimeve të mjaftueshme për verifikimin e shërbimeve ligjore të faturuara.
- A4 Ndryshim i çmimit të ofertës së operatorit fitues jo në pajtim me kërkesat ligjore.
- A5 Tejkalim i afatit ligjor për ushtrim të funksionit diplomatik dhe konsullor në 20 misione diplomatike dhe konsullore.
- A6 Tejkalim i afatit ligjor për pozitat me ushtrues detyre.
- A7 Ushtrimi i mandatit në mision diplomatik përtej kërkesave ligjore të moshës së pensionimit.
- B1 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar ishin të nënvlerësuar për 172,222€.
- A8 Nënvlerësim i obligimeve të papaguara për 62,088€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPJD-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Procesi i raportimit në MPJD ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV). Pas kërkesës sonë për korrigjime, çështjet e identifikuar nga ne në lidhje me PFV janë korrigjuar. Mangësi në prokurim, mangësi në lidhje me menaxhimin e pasurive, mangësi në raportimin e detyrimeve kontingjente, menaxhim jo të mirë të kontratave, mangësi në raportimin e detyrimeve kontingjente, mangësi në raportimin e obligimeve të papaguara të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të ndikojnë në përmirësimet e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese si dhe të kontrolleve të brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre 12 janë rekomandime të reja një (1) pjesërisht i zbatuar dhe një (1) i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Specifikimi i markës tregtare dhe i prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë

Gjetja

Neni 28 paragrafi 7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përcakton se “Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”

Po ashtu Rregullorja nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 11 paragrafi 11.1 i këtij ligji përcakton se “Zyrtari përgjegjës i prokurimit (ZPP) është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK brenda kompetencave të tij dhe në pajtim me dispozitat e LPP”.

Te projekti “Renovimi dhe riorganizimi i bodrumit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe aneks objektit”, në vlerë 359,638€, tek dosja e tenderit në paramasë dhe parallogari janë specifikuar shenja dalluese (marka tregtare) të produkteve dhe emra të prodhuesve në disa pozicione.

Në kuadër të paramasës së arkitekturës tek suvatimi, gipskartoni dhe ngjyrosja, respektivisht në pozicionin 1.04.14 që ka të bëjë me furnizimin dhe montimin e tavanit, është specifikuar produkti të jetë THERMATEX® Metall / Kombimetall, ndërsa për fugim është kërkuar përdorimi i materialit nga prodhuesi Uniflot.

Në kuadër të punimeve të nivelizimit, respektivisht në pozicionin 1.05.02 është specifikuar termoizolimi XPS®, ndërsa në pozicionin 1.05.04 është paraparë furnizimi dhe punimi i dyshemesë me epoksid Mapefloor Comfort AR.

Në kuadër të punimeve të hidroizolimit, respektivisht në pozicionin 1.06.02 janë specifikuar materialet Mapelastic Foundation dhe Mapergrout 430.

Vlen të theksohet se në fillim të kësaj paramse dhe parallogarie është shtuar fjalia “Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjta ose më të mira që duhet dëshmuar me çertifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv”.

Megjithatë, në asnjërin nga rastet e lartpërmendura, zyra e prokurimit nuk ka arsyetuar ekzistimin e kushteve të jashtëzakonshme dhe nuk ka vërtetuar se ishte e pamundur hartimi i specifikimeve teknike të sakta dhe të kuptueshme pa referencë në shenja dalluese dhe pa shoqëruar fjalën “ose ekuivalent”, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Në kuadër të të njëjtit aktivitet prokurimi, në pjesën e paramasës dhe paralogarisë që ka të bëjë me punët e elektrikës është specifikuar: “Furnizimi dhe montimi i tabelës KSH-B e tipit PrismaSet G 12M, prodhues Schneider ose të ngjashme me elementet përbërëse”. Megjithatë, edhe në këtë rast, në dosje nuk është dhënë asnjë arsytim apo dëshmi se pse ka qenë e pamundur hartimi i specifikimeve teknike pa referencë në prodhuesin e caktuar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve efektive nga Zyra e Prokurimit për parandalimin e specifikimit të markave tregtare dhe emrave të prodhuesve në paramasë dhe paralogari.

- Ndikimi** Specifikimi i markave tregtare dhe emrave të prodhuesve në paramasë dhe paralogari mund të ndikojë në kufizimin e konkurrencës dhe në trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.
- Rekomandimi A1** Ministri të shtojë kontrollet për të siguruar që në paramasë dhe paralogari të mos specifikohen marka tregtare apo prodhues, përveç rasteve të jashtëzakonshme të lejuara me Ligjin për Prokurimin Publik, kur vërtetohet se nuk mund të hartohet një specifikim i saktë, dhe në këto raste të përdoret formulimi “ose ekuivalent”.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mosrespektim i procedurave të prokurimit

- Gjetja** Udhëzimi i Prokurimit për Misionet Diplommatike/ Konsullore të Republikës së Kosovës pika 4.1 përcakton “Misioni Diplommatik/Konsullor do të përdorë procedurën e kuotimit të çmimeve për çfarëdo kontrate publike, vlera e parashikuar e cila është e barabartë apo më e madhe se 1,000€ por më pak se 10,000€. Procedura e kuotimit të çmimit do të kryhet me metodën Kërkesa për Kuotim, e marrjes së tri kuotimeve”. Pika 4.5 parasheh se “Misioni Diplommatik/Konsullor do të përcaktoj të gjitha specifikacionet teknike/ TER të cilat çdo ofertë duhet t’i përmbush. Misioni Diplommatik/Konsullor do të përcakton qartë në specifikime se çka kërkohet të dorëzohet për Furnizime/Mallra dhe kur kërkohet një Shërbim, të përcaktohet saktësisht se çka pritët nga ofruesi i Shërbimit”. Pika 4.6 “Specifikimet teknike duhet t’iu ofrojnë qasje të barabartë ofertuesve dhe të mos kenë efekt të krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e konkurrencës në prokurimin publik”.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se në tri (3) raste misionet diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës nuk kishin respektuar kërkesat e parapara me udhëzimin e Prokurimit për Misione Diplommatike pasi ata nuk kishin hartuar specifika teknike dhe nuk kishin marr nga tri (3) oferta me kuotime. Rastet janë:

Ambasada e Kosovës në Berlin të Gjermanisë-marrëveshja e lidhur për ofrimin e shërbimeve për këshillim dhe përfaqësim ligjor, me çmim prej 300€ për orë pune.

Aktivitetet e për Festën e Pavarësisë së Kosovës të organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Romë të Italisë si:

- Blerjen e dhuratave për mysafir me vlerë të parashikuar 2,880€;
- Zërimi për sallën me vlerë të parashikuar 1,660€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm, përkatësisht mungesës së kontrolleve efektive në procesin e prokurimit nga ana e misioneve për hartimin e specifikave teknike dhe sigurimin e konkurrencës përmes së paku tri kuotimeve.

Ndikimi	Mungesa e specifikave teknike mund të ndikojë që pranimi i shërbimeve apo blerja e produkteve të mos u përgjigjen nevojave reale të misionit, duke shkaktuar shpenzim joefektiv të buxhetit. Mosmarrja e tri (3) kuotimeve pamundëson konfirmimin e çmimit të tregut dhe eliminon konkurrencën e kërkuar për të garantuar trajtim të barabartë të operatorëve.
Rekomandimi A2	Ministri duhet të sigurojë që misionet diplomatike/konsullore, për çdo aktivitet të prokurimit të zhvilluar, të hartojnë paraprakisht specifikacionet teknike të qarta dhe të sigurojnë së paku tri (3) kuotime, me qëllim që të garantojnë transparencë dhe konkurrencë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mungesë e monitorimit dhe të dëshmimeve të mjaftueshme për verifikimin e shërbimeve ligjore të fatuara

Gjetja	<p>Neni 70 i Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 70.18 përcakton “ZKA do të emërojë një person nga Njësia Kërkuese me shkathtësi dhe përvojë të duhur, si Menaxher të Kontratës dhe një person nga Njësia Kërkuese si Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës”.</p> <p>Gjatë auditimit është konstatuar se Ambasada e Republikës së Kosovës në Berlin ka lidhur me datën 13.07.2023 një marrëveshje me një firmë për këshillim dhe përfaqësim ligjor, me çmim prej 300€ për orë pune. Për këtë kontratë nuk është emëruar menaxher i kontratës, gjë që ka kufizuar mundësinë e monitorimit dhe verifikimit të zbatimit të saj sipas kushteve të përcaktuara.</p> <p>Nga mostra e testuar është vërejtur se operatori ekonomik ka faturuar Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës në Frankfurt për shërbime të ofruara ndaj kësaj konsullate, në vlerë totale prej 39,181€. Ndonëse Konsullata ka ekzekutuar pagesën, nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe relevante (si p.sh. time-sheets të detajuara ose output-e specifike), që vërtetojnë se orët e fatuara korrespondojnë me shërbimet reale të kryera.</p> <p>Kjo ka ndodhur si rezultat i mos-emërimit të një menaxheri të kontratës dhe mungesës së një procesi formal për pranimin e shërbimeve (Raporti i pranimit), i cili do të duhej të verifikonte saktësinë e orëve të fatuara përpara se të procedohej me pagesën.</p>
---------------	---

Ndikimi	Mungesa e dëshmimeve të mjaftueshme mbështetëse për verifikimin e orëve të punës dhe mos-emërimi i menaxherit të kontratës rrit rrezikun që pagesat të mos jenë plotësisht të justifikuara dhe të mos pasqyrojnë shërbimet realisht të kryera.
Rekomandimi A3	Ministri duhet të sigurojë që për marrëveshje aktive të emërohet një menaxher kontrate, i cili bën verifikimin paraprak të faturave bazuar në dëshmi të mjaftueshme dhe relevante.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Ndryshim i çmimit të ofertës së operatorit fitues jo në pajtim me kërkesat ligjore****Gjetja**

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve parasheh "Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor".

Po ashtu Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 40 paragrafi 40.1 parasheh se "Komisioni Vlerësues është përgjegjës për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Tenderëve në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP". Përderisa paragrafi 40.2 parasheh se "Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve". Më tutje, paragrafi 40.9 ndër tjera parasheh se "Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në rast se shuma e korigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminojë OE dhe do të informoj me shkrim OE".

Me paragrafin 39.11 të nenit 39 parashihte që "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit vlerësues dhe të nxjerrë vendimin përfundimtar mbi dhënien e kontratës, apo të refuzojë atë duke dhënë arsyet me shkrim, të njoftojë menjëherë Zyrtarin Kryesor Administrativ për këtë refuzim, dhe të kërkojë rivlerësimin e tenderëve.

Gjatë shqyrtimit të procedurës së prokurimit për "Shërbimet e mirëmbajtjes higjienike", është konstatuar se Komisioni Vlerësues ka ndërhyrë në çmimin total të ofertës së Operatorit Ekonomik (OE) fitues, duke e zbritur atë nga 134,450€ në 124,450€ (një ndryshim prej 10,000€) nën arsyetimin e korigjimit të gabimeve aritmetike që kanë të bëjë me rekapitullim total dhe TVSH. Mbi këtë bazë të ndryshuar, Autoriteti Kontraktues ka lidhur kontratën në vlerë (124,450€) me datë 24.12.2025.

Nga analiza jonë e dokumentacionit të ofertës, rezultoi se:

Nuk është identifikuar asnjë gabim aritmetik në përlogaritjet e OE. Çmimet për njësi të shumëzuara me sasinë për secilin pozicion ishin të sakta dhe përkonin saktësisht me totalin e deklaruar prej 134,450€. Rrjedhimisht, nuk ka pasur bazë ligjore për asnjë lloj korigjimi.

Për më tepër, edhe në rast se do të supozohej ekzistenca e një gabimi

aritmetik, ndryshimi prej 10,000€ përbën rreth 7.44% të vlerës totale të ofertës. Kjo tejkalon dukshëm kufirin maksimal prej +/-2% të lejuar me ligj për përmirësime aritmetike. Sipas rregullativës në fuqi, në rast se gabimi tejkalon +/- 2%, OE duhet të eliminohet si i papërgjegjshëm.

Ndërhyrja në çmimin e ofertës ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të dispozitave ligjore dhe rregullative nga komisioni vlerësues, si dhe të kontrollit të pamjaftueshëm nga zyra e prokurimit në sigurimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit.

Ndikimi

Ndërhyrja në çmimin total të ofertës paraqet rrezik për mosrespektimin e parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mund të cenojë integritetin dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme në mënyrë që Komisionet Vlerësuese t'u përmbahen me përpikmëri kërkesave ligjore. Nuk duhet të lejohet asnjë ndërhyrje në çmimet e ofertave kur nuk ka gabime aritmetike, dhe në rastet kur ato ekzistojnë, korigjimi nuk duhet të kalojë limitin prej 2%. Gjithashtu, të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit do të refuzojë rekomandimet e komisionit vlerësues që bien ndesh me këto kritere duke dhënë arsyet me shkrim dhe të kërkojë rivlerësim, ose të eliminojë ofertat e papërgjegjshme për të ruajtur integritetin e procesi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Tejkallim i afatit ligjor për ushtrim të funksionit diplomatik dhe konsullor

Gjetja

Neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-122 Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, specifikon "Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision diplomatik për një periudhë katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme".

Po ashtu neni 16 i këtij ligji specifikon "I ngarkuari me punë emërohet me dekret të Presidentit, pas propozimit të Qeverisë. Procedurat për akreditimin e të ngarkuarit me punë zbatohen nga Ministria e Punëve të Jashtme. I ngarkuari me punë i përkohshëm emërohet nga Ministri i Punëve të Jashtme. Në mungesë të shefit të misionit ose në rast pamundësie të shefit të misionit për të ushtruar funksionet e tij/saj, një i ngarkuar me punë i përkohshëm vepron përkohësisht si shef i misionit".

Neni 2 paragrafi 7.8 i Ligjit Nr. 03/L-207 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-044 Për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, specifikon "Të emëruarit në pozitën e Ambasadorit dhe Shefit të Misionit që nuk janë anëtarë në detyrë të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës shërbejnë vetëm për një mandat, dhe pas përfundimit të këtij mandati, nuk konsiderohen pjesë e Shërbimit të Jashtëm".

Neni 10 i Rregullores Nr. 02/2009 Për Shërbimin e Jashtëm, specifikon "Ambasadorët / Të ngarkuarit me punë/ Shefat e misionit, si rregull, caktohen të shërbejnë për katër (4) vite. Zyrtarët e lartë Konsullorë (Konsull i Përgjithshëm, Konsulli) zakonisht caktohen në detyrë për një kohëzgjatje (katër) 4 vjeçare".

Nga testimi i mostrave dhe popullacionit të pagave për stafin e ministrisë,

kemi identifikuar se në 20 misione diplomatike dhe konsullore, personeli diplomatik dhe konsullor kanë vazhduar me ushtrimin e funksionit dhe janë paguar edhe pas skadimit të mandatit ligjor me dekret. Personelit i ka skaduar mandati ligjor 4 (katër) vjeçar gjatë periudhës 2022 (një rast), 2023 (shtatë raste) dhe 2025 (dymbëdhjetë raste), dhe është në pozitat/gradat Ambasador, Konsull i Përgjithshëm. Lidhur me këtë, nuk ishte nxjerr dekret tjetër për vazhdim të mandatit apo ngarkim me punë në misione. Duhet theksuar se nga këta 20 personel diplomatë, 9 (nëntë) prej tyre nuk janë anëtarë të përhershëm të Ministrisë - Anëtarë të shërbimit të jashtëm.

Kjo situatë ishte rrjedhojë e mos inicimit të procedurës nga ana e MPJD, për menaxhim të përfundimit të mandateve të shefave në misione.

Ndikimi Ushtrimi i funksionit diplomatik dhe konsullor në misione përtej afatit ligjor, paraqet mangësi ligjore.

Rekomandimi A5 Ministri të shtoj kontrollet e brendshme për menaxhimin e përfundimit të mandateve të shefave të misioneve të Republikës së Kosovës, në përputhje me kërkesat e parapara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Tejkallim i afatit ligjor për pozitat me ushtrues detyre

Gjetja Neni 35 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik specifikonte “ Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm”.

Vlenë të theksohet se ky ligj ishte në fuqi për rastet që ne po i trajtojmë, më pas në qershor të vitit 2025 ishte ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik.

Ne kemi identifikuar se në tre (3) raste pozitat e rregullta të punës mbaheshin me Ushtrues Detyre, që tejkallonin afatin e paraparë ligjor. Për këto pozita, nuk ishte shpallur konkurs gjatë vitit 2025 edhe përkundër faktit se ishin përfshirë në planin vjetor të personelit për rekrutim.

Pozita Udhëheqës/e të Divizionit të Prokurimit mbahej me ushtrues detyre nga periudha prej 25.10.2023 deri më 25.10.2024, po ashtu për këtë pozitë ishin nxjerr dy (2) vendime për emërim Zëvendësuese me afat të përcaktuar prej 26.10.2024 - 25.04.2025 dhe 25.04.2024 - 24.10.2025, njëkohësisht me vendim tjetër kjo pozitë vazhdonte me ushtrues detyre prej 25.04.2024-24.10.2025.

Pozita Udhëheqës/e i Divizionit për Buxhet dhe Financa ishte mbajtur me ushtrues detyre prej 01.09.2024 deri më 31.08.2025. Pozita kishte vazhduar të mbahej me ushtrues detyre edhe për periudhën prej 01.07.2025 - 31.12.2025.

Duhet theksuar se pozitat e cekura më lart vazhdojnë të mbahen me ushtrues detyre edhe gjatë vitit 2026, respektivisht gjatë periudhës tonë audituese.

Pozita Udhëheqës/e i Divizionit për Organizata Ndërkombëtare - Departamenti për Organizata Ndërkombëtare kishte vazhduar të mbahej me ushtrues detyre prej 01.09.2024 deri më 28.02.2025, si dhe ishte vazhduar edhe me dy (2) vendime tjera me afat të caktuar prej 01.03.2025-30.06.2025 dhe 01.07.2025-31.12.2025.

Sipas konfirmimit që kemi pranuar nga njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore të ministrisë, theksojnë se përveç aspektit të opinionit ligjor, kanë ekzistuar dhe problematika të tjera për shkak të specifikave të ministrisë, e të cilat kanë qenë se me rastin e kthimeve të diplomatëve është obligim i Ministrisë që të njëjtit të sistemohen në pozita ekuivalente, andaj dhe nuk mund të mbulohen pozita të nivelit drejtues duke ditur që ka diplomat/shefa të misioneve që para shkuarjes në misione kanë mbajtur pozita drejtuese.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave me Ushtrues Detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor rrezikon që pozitat e ndryshme të mbahen nga zyrtarë të cilët nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për pozitat adekuate. Po ashtu, mungesa e zyrtarëve me mandat të rregullt në pozita kyçe udhëheqëse rrezikon në dobësimin e kontrolleve të brendshme, vendimmarrjen afatgjatë dhe llogaridhënien.

Rekomandimi A6

Ministri duhet të sigurojnë që të ndërmerren veprimet e nevojshme për të plotësuar pozitat e rregullta të punës përmes procedurave të rekrutimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe të evitohet praktika e mbulimit të këtyre pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Ushtrimi i mandatit në mision diplomatik përtej kërkesave ligjore të moshës së pensionimit

Gjetja

Neni 73 i Ligjit Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët publik specifikon "Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur mbushet moshë për pensionim sipas Ligjit të Punës".

Neni 67 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 specifikon "Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet kur i punësuari mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç".

Neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-044 Për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës specifikon "Anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjore me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së ambasadave dhe misioneve ose zyrave tjera jashtë Kosovës".

Zyrtari i ministrisë personel i karrierës (pjesë e Shërbimit Civil), ishte emëruar Ambasador në Republikën e Shqipërisë me dekret të Presidentes në shtator të vitit 2021. Ndërsa kishte arritur moshën e pensionimit në nëntor të po të njëjtit vit, pra 2021. Ambasadori që nga ajo kohë vazhdon të

ushtrrojë mandatin e tij në mision diplomatik dhe paguhet me pagë pas moshës së pensionimit, jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Kjo gjendje ishte rrjedhojë e mungesës së veprimeve të nevojshme ndër institucionale, për respektim të kërkesave ligjore të moshës së pensionimit për zyrtarin e karrierës në Ministri.

Ndikimi Vazhdimi i mandatit dhe pagesa në mision diplomatik për zyrtarin e karrierës të Ministrisë, edhe pas arritjes së moshës së pensionimit, paraqet mos pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi.

Rekomandimi A7 Ministri duhet të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore për moshën e pensionimit të stafit të karrierës në Ministri.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Nënvlërësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) në vlerë 43,526€, ishin të nënvlërësuara për 172,222€. Vlera që është dashtë të prezantohet në RVF është 215,748€.

Kjo ka ndodh për shkak se ministria nuk i kishte prezantuar detyrimet kontingjente të misioneve diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Nënvlërësim i obligimeve të papaguara

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF-Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatata buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Ministria, në nenin 17 të RVF-së, nuk kishte prezantuar asnjë obligim të papaguar, me ç'rast paraqitja rezultoi e pasaktë. Faturat e papaguara të Ambasadës së Romës në vlerë prej 62,088€ nuk janë prezantuar fare. Si rezultat, detyrimet e papaguara në RVF janë të nënvlërësuara për këtë vlerë.

Kjo çështje ka ardhur si pasojë e dobësive në kontrollet e brendshme në Zyrën e Financave, lidhur me raportimin e saktë dhe të plotë të obligimeve të papaguara.

Ndikimi Mosprezantimi i plotë i obligimeve të papaguara në RVF ndikon që palët e interesit, përkatësisht shfrytëzuesit e RVF-së, të marrin informata të pasakta lidhur me nivelin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të sigurojë që Zyra e Financave t'i prezantojë të gjitha obligimet e papaguara në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 8,552,985€, prej tyre ishin shpenzuar 8,552,985€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 389, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 345.

Çështja C1 - Mungesë e miratimit të rregullores për pranimin e stafit lokal në Misione Diplomatike dhe Konsullore

Gjetja

Neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës specifikon “Qeveria merr vendime dhe nxjerr akte të tjera juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve. Miraton dokumente strategjike dhe plane të ndryshme në zbatim të ligjeve e politikave të Qeverisë”. Neni 38 i Ligjit Nr. 03/L-122 Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës specifikon “ Ministria e Punëve të Jashtme ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji”.

Ministria gjatë vitit 2025 kishte hartuar Draft-Rregulloren për rekrutimin e stafit vendor në misionet Diplomatike dhe Konsullore (MDK). Draft-Rregullorja parasheh procedurat dhe kriteret e rekrutimit të personelit vendor, të drejtat dhe detyrimet mbi marrëdhënien e punës, caktimin e pagës minimale dhe të tjera. Megjithatë, kjo rregullore nuk ishte proceduar për miratim në Qeveri gjatë vitit 2025. Rrjedhimisht gjatë vitit 2025, procesi i rekrutimit të personelit vendor - Asistent në 14 misione diplomatike dhe konsullore ishte zhvilluar në mungesë të rregullores së miratuar.

Sipas konfirmimeve që kemi pranuar nga zyrtarët kompetent të ministrisë, Draft-Rregullorja nuk ishte proceduar për miratim për shkak të situatës politike në vend. Megjithatë, sipas tyre, është përfshirë në agjendën legjislativë të ministrisë për vitin 2026 dhe pritet të procedohet për miratim në Qeveri.

Ndikimi

Rekrutimi i stafit lokal në misionet diplomatike dhe konsullore në mungesë të rregullores së miratuar, krijon paqartësi në procedurat e rekrutimit dhe rrit rrezikun për trajtim të pabarabartë. Poashtu, kjo situatë mund të krijoj pasiguri lidhur me të drejtat dhe detyrimet e stafit, si dhe vështirësi në vlerësimin e performancës së tyre.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të sigurojë procedimin dhe miratimin e draft rregullores brenda një afati të shkurtër kohor. Njëkohësisht, pas miratimit, të sigurojë zbatimin e saj në të gjitha misionet diplomatike dhe konsullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë komunalitë, ishte 26,300,480€. Shpenzimet e realizuara ishin 23,459,351€, të cilat kishin të bëjnë me udhëtime zyrtare, shpenzime akomodimi për delegacione, avance për Ambasada dhe të tjera.

Çështja A9 - Mosrespektimi i afatit ligjor për pranimin e tenderëve

Gjetja

Neni 44 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës parasheh se "Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve. Kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzetë (40) ditë". Po ashtu neni 46 i këtij ligji nder tjera parasheh se " Nëse ekzistojnë rrethanat që: (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktojnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore që përcaktohen me këtë nen".

Zyra e Prokurimit për një aktivitet të prokurimit me procedurë të hapur për kontratë shërbimi kornizë me vlerë të madhe, nuk kishte respektuar kërkesën ligjore në lidhje me afatin prej 40 ditëve për pranimin e tenderëve. Afati që ishte përcaktuar për pranimin e tenderëve ishte 21 ditë, pra nga data 19.08.2025-09.09.2025. Kontrata kishte të bëjë me "Shërbimet e transportit ajror", në vlerë prej 497,014€. Për shkurtim të afatit zyra e prokurimit nuk kishte bërë njoftimin paraprak para publikimit të njoftimit të kontratës siç kërkohet me ligj.

Arsyetimi i dhënë në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit për shkurtim të afateve, ishte se kontrata paraprake ishte po thuajse në përfundim gjithashtu gjatë sezonës së verës, MPJD ka disa aktivitete të ndryshme të cilat do të mund të shpejtojnë përfundimin e kontratës.

Ndikimi

Mosrespektimi i afateve ligjore për pranimin e tenderëve për aktivitetet e prokurimit me procedurë të hapur për kontrata me vlera të mëdha, pa ndonjë arsye të bazuar, mund të ndikoj në kufizimin e konkurrencës duke ulur mundësitë për pjesëmarrje të barabartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe të pamundësojë përgatitjen dhe dorëzimin me kohë dhe në mënyrë të plotë të ofertave.

Rekomandimi A9

Ministri duhet të forcojë dhe shtojë kontrollet për të siguruar që Zyra e Prokurimit të respektojë plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për pranimin e tenderëve, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 25,605,430€, pasurive jokapitale është 1,158,490€, si dhe e stoqeve 45,385€.

Çështja A10 - Mos formimi i komisionit të inventarizimit të pasurive jofinanciare dhe mos realizimi i inventarizimit në misionet diplomatike dhe konsullore

Gjetja

Neni 18 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore nder të tjerash parasheh se “Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare”. Neni 5, 6, 7 dhe 12 i Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 Për Regjistrimin e Pasurisë në Misionet Diplommatike a Konsullore të Republikës së Kosovës specifikon “Komisionin për vlerësim të pasurive në Misionet diplomatike a konsullore e themelon Shefi i misionit diplomatik a konsullor si organ ad hoc. Komisionin për inventarizimin e pasurive e formon Shefi i misionit diplomatik a konsullor në përbërje jo më pak se tre anëtarë. Komisioni për inventarizim harton Raporte të komisioneve individuale dhe Raportin e përgjithshëm për kryerjen e inventarizimit. Misionet diplomatike a konsullore, detyrohen një herë në vit, përpara përfundimit të çdo vitit fiskal, të kryejnë njësimin fizik apo inventarizimin e të gjitha pasurive që janë në zotërim të tyre”.

Në Misionet diplomatike dhe konsullore, respektivisht Ambasadën në Lubjanë, Slloveni, dhe Konsullatën e Përgjithshme në Varshavë, Poloni, nuk ishin formuar komisionet për inventarizimin e pasurive jofinanciare dhe vlerësimin e pasurisë. Rrjedhimisht, në këto misione nuk ishte kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë për vitin 2025.

Po ashtu, MPJD nuk kishte përgatitur raport të përgjithshëm të inventarizimit duke përfshirë raportimin për misionet tjera diplomatike dhe konsullore. Komisionet e formuara nga misionet tjera kishin kryer procesin e inventarizimit dhe kishin përgatitur vetëm raporte individuale të cilat nuk ishin përfshirë në një raport të përgjithshëm të konsoliduar të ministrisë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit të duhur nga ana e Shefat e Misionit diplomatik/konsullor, për të formuar komisionin për inventarizimin e pasurive jofinanciare dhe vlerësimin e pasurisë, dhe realizimin e inventarizimit, vlerësimit të pasurisë. Ndërsa mos përgatitja e raportit të përgjithshëm të inventarizimit duke përfshirë misionet diplomatike dhe konsullore ka ndodhur për shkak të praktikës së aplikuar ndër vite në këtë formë raportimi.

Ndikimi

Mos formimi i komisionit të inventarizimit të pasurive jofinanciare dhe vlerësimit të pasurisë në misione diplomatike dhe konsullore dhe mos realizimi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë, rrit rrezikun për një prezantim të pasaktë dhe jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare të ministrisë. Ndërsa, mos përgatitja e raportit të përgjithshëm të inventarizimit reflekton pasqyrë të fragmentuar dhe jo të saktë për gjithë ministrinë.

Rekomandimi A10

Ministri dhe Shefi i Misionit diplomatik/konsullor të ndërmarrin masa për forcimin e kontroleve të brendshme, duke formuar komisionin për

inventarizimin e pasurive jofinanciare dhe vlerësimin e pasurisë , dhe të sigurojë inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative. Po ashtu, të sigurohet përgatitja e raportit të përgjithshëm të inventarizimit të pasurisë duke përfshirë raportimin për misionet diplomatike dhe konsullore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mosmbyllja e investimeve në vijim dhe moskalimi i tyre në pasuri në përdorim

Gjetja

Neni 11 i Rregullores MF Nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare Në Organizatat Buxhetore specifikon “ Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimin të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi”.

Në dy (2) raste kemi identifikuar se pasuria jo-financiare kapitale në vlerë prej 584,008€ nuk është transferuar nga investimet në vijim në pasuri në përdorim. Si rrjedhojë, këto pasuri do të duhej të transferoheshin në pasuri në përdorim dhe të fillonte aplikimi i zhvlerësimit përkatës, pasi që punimet përkatëse kishin përfunduar. Kontratat e punimeve kanë të bëjnë me projektet: “Riorganizimi i hyrjes në MPJD, ndarja e hyrjes protokollare, rregullimi i pllatosë së oborrit dhe fasadimi i objektit”, “Renovimi dhe riorganizimi i bodrumit”, si dhe “Renovimi dhe riorganizimi i bodrumit - punë shtesë”.

Sipas konfirmimit të zyrtarit të pasurisë, kjo situatë kishte ndodhur si pasojë e mungesës së njohurive kontabël për trajtimin e regjistrimit të projekteve investive, të cilat konsiderohen si investime në vijim dhe për të cilat nuk ishte e qartë nëse duhej të bashkëngjiteshin në vlerën e objektit në pronësi të MPB-së.

Ndikimi

Mosmbyllja e investimeve në vijim ndikon në llogaritjen e zhvlerësimit dhe në vlerën neto të pasurisë, si dhe çon në pasqyrim jo të saktë dhe jo të drejtë të pasurisë në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A11

Ministri duhet të sigurojë që pasuritë e përfunduara të transferohen me kohë nga investimet në vijim në pasuri në përdorim. Po ashtu, duhet të fillohet aplikimi i zhvlerësimit përkatës në përputhje me rregullativën ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në MPJD operon me një staf prej tre auditorësh të brendshëm. Për vitin 2025, kjo njësi ka hartuar planin vjetor të punës, i cili bazohet në planin strategjik, duke planifikuar gjithsej dhjetë auditime. Nga këto auditime janë përgatitur raporte që përmbajnë 33 rekomandime. Prej tyre, 8 rekomandime janë zbatuar plotësisht, ndërsa 25 të tjera janë në proces zbatimi. Nuk ka asnjë rekomandim të pazbatuar. Raportet e NJAB mbulojnë kryesisht periudhën kohore 2023-2025.

Çështja A12 - Mosformimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e sektorit publik, neni 4, pika 1, përcakton që "çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm në nivel të organit kryesor, sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit ". Ndërsa neni 6 thekson se "Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë".

Ministria, gjatë vitit 2025, nuk e kishte të formuar Komitetin e Auditimit. Mandati i Komitetit paraprak kishte skaduar në janar të vitit 2025, ndërsa nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për emërimin e anëtarëve të rinj.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve nga ana e ministrisë për emërimin e anëtarëve të rinj të Komitetit të Auditimit.

Ndikimi Mosformimi i Komitetit të Auditimit krijon mungesë të mbikëqyrjes efektive të punës së NJAB-së, si dhe të kontrollit mbi menaxhimin financiar dhe operativ, dhe rrit rrezikun për parregullsi. Në mungesë të këtij mekanizmi, dobësohet mbikëqyrja e funksionit të auditimit të brendshëm, si dhe rishikimi i efektivitetit të kontroleve të brendshme, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të qeverisjes.

Rekomandimi A12 Ministri duhet të sigurojë funksionalizimin e Komitetit të Auditimit përmes ndërmarrjes së veprimeve për emërimin e anëtarëve në përputhje me kërkesat e Udhëzimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjatë procesit të auditimit ne i kemi pranuar draft PFV e ministrisë, dhe i kemi analizuar ku janë identifikuar çështje materiale të cilat pas sugjerimeve tona menaxhmenti i organizatës buxhetore i ka bërë korrigjimet në PFV finale. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit.

Çështja 1

Gabimet e identifikuara në prezantimin e PFV

Gjetja

Gjatë rishikimit të pasqyrave financiare vjetore u identifikuan disa mospërputhje dhe prezantime jo të sakta si:

Te Neni 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, në pjesën e parë që i referohet fondeve (Llogaria e Vetme e Thesarit për vitet 2024 dhe 2023), shuma e fondeve nga të cilat është realizuar pagesa/shpenzimi nuk përputhet me vlerat e prezantuara në pasqyrat financiare të vitit 2024. Si rrjedhojë, krahasueshmëria e pranimeve dhe shpenzimeve ndërmjet viteve nuk është e saktë dhe nuk paraqet informacion të plotë financiar. Kjo pasaktësi e vlerave për vitet 2024, është te pjesa me e madhe e tabelave të prezantuara në PFV e 2025.

Te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, në pjesën *Hyrja e parasë së gatshme*, te shtylla Buxheti final (B), në Shënimin 9 - Hyrja jo tatimore, Ministria ka prezantuar si buxhet final vlerën prej 2,521,900 €. Ndërsa, sipas Ligjit për Buxhetin Nr. 08/L-332 për vitin 2025, këtu duhet të prezantohet vlera prej 7,570,433€.

Po ashtu, te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, në pjesën *Hyrja e parasë së gatshme*, te shtylla Realizimi (A), në Shënimin 9 - Hyrja jo tatimore, Ministria ka përfshirë edhe kodin 61000 si të hyra në vlerë 22,320 €, gjë që nuk është dashur të përfshihet këtu. Kjo pastaj reflektohet edhe në shpalosjet e shënimit.

Gjithashtu, te neni 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit, në pjesën *Hyrja e parasë së gatshme*, te shtylla Realizimi (A), në Shënimin 12 - Tjera, Ministria duhet të prezantojë kthimin nga kodi 61000 në vlerë 22,320 €, çka më pas duhet të reflektohet edhe në shpalosjet përkatëse të shënimit.

Te Neni 14.6 Shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, në pjesën e hyrjeve, duhet të harmonizohen në bazë të ndryshimeve që janë bërë në dy tabelat e para.

Po ashtu, te shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit në pjesën e hyrjeve, në buxhetin përfundimtar është prezantuar gabimisht vlera prej 2,521,000€.

Në shpalosjet e shënimeve sipas kategorive ekonomike, Ministria nuk e ka prezantuar drejt dhe saktë buxhetin final. Në shtyllat e buxhetit final, sipas kategorive ekonomike, në shpalosje është paraqitur buxheti fillestar në vend të buxhetit final.

Neni 20 - Raporti për avancet e paarsyetuara- Ministri ka shpalosur me fjalë avancet që kanë mbetur të hapura. Megjithatë, në tabelën në fillim të raportit duhet të përfshihet edhe shuma totale e avanceve të hapura, në mënyrë që informacioni të jetë i plotë dhe i paraqitur qartë.

Neni 24 - Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara- Ministria ka paraqitur gabimisht bartjen e saldosh përfundimtare nga viti 2024 në fillim të vitit 2025, duke rezultuar në paraqitje jo të saktë të gjendjes së fondeve të donatorëve të pashpenzuara.

Po ashtu, për vlerat e prezantuara në nenin 18 dhe 19, sigurohuni që i keni paraqitur saktë, për shkak se në këtë fazë nuk kemi shënime të detajuara për këtë pjesë.

Veprimi i kërkuar Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për ti korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore, në mënyrë që ato të paraqesin saktë gjendjen financiare në përputhje me rregullat e raportimit financiar.

Rezultati Menaxhmenti kishte marrë veprime korigjuese për paraqitje të drejtë dhe të saktë të PFV gjatë procesit të auditimit dhe kishte bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PFV e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	49,496,776	40,701,211	35,284,194	35,801,906	37,935,849
Grante Qeveritare - Buxheti	49,496,776	40,387,771	35,090,059	35,673,659	37,541,693
Donacionet vendore	0	86,874	65,811	25,330	94,795
Donacionet e jashtme	0	226,567	128,325	102,917	299,361

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 8,795,565€. Kjo zvogëlim nga granditë i qeveris për 9,109,005€, si dhe rritje nga granditë i përcaktuar i donatorëve në vlerë prej 313,441€.

Në vitin 2025, MPJD ka shpenzuar rreth 87% të buxhetit final a po 35,284,194€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	49,496,776	40,701,211	35,284,194	35,801,906	37,935,849
Pagat dhe mëditjet	8,261,226	8,552,985	8,552,985	8,653,248	6,130,024
Mallrat dhe shërbimet	21,796,000	25,612,506	22,844,464	22,193,582	18,724,977
Komunalitë	1,044,551	687,973	614,887	642,914	698,193
Subvencionet dhe transferet	2,000,000	755,700	755,700	1,168,623	621,910
Investimet Kapitale	16,395,000	5,092,047	2,516,157	3,143,539	11,760,746

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje me vendim të qeverisë ishte rritur për 291,759€, krahasuar me buxhetin fillestar.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 3,816,506€. Kjo rritje vjen si rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 3,503,065€ . Po ashtu buxheti për këtë kategori ishte rritur për 310,364€, nga granditë e donatorëve. Shpenzimet në këtë kategori arritën në rreth 89% të buxhetit final. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve, shpenzime për sigurime shëndetësore, shpenzime të qirasë, shpenzimet e mobilimit për diplomatët, shpenzimet e pagave për stafin vendor që punojnë në misione.

Buxheti final për komunalitë është zvogëluar për 356,578€, me vendim të qeverisë për kursime buxhetore.

Buxheti final për subvencione ishte zvogëluar me vendime të qeverisë për kursime buxhetore për 1,244,300€.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendim të qeverisë për kursime buxhetore për 11,302,953€ për shkak të pamundësisë së blerjeve të objekteve për ambasada. Shpenzimet në këtë kategori arritën në rreth 49% të buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



MPJD për vitin 2025, kishte realizuar 2,521,904€. Të hyrat e realizuara kanë të bëjë me taksat për dokumente të udhëtimit, taksat për verifikim të dokumenteve, taksat për shtetësi dhe taksat tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	7,570,433	7,570,433	2,521,904	4,241,164	6,062,650
Të hyrat jo tatimore	7,570,433	7,570,433	2,499,584	4,236,269	5,642,929
Të hyrat tjera	0	0	22,321	4,894	419,722

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024, kishte rezultuar me pesë rekomandime. Ministria kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë, tri (3) rekomandime ishin zbatuar një (1) ishte zbatuar pjesërisht dhe një (1) rekomandim nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të siguroj hartimin e një rregullore të qartë për rekrutimin e stafit lokal në misionet diplomatike, e cila do të përcaktojë procedurat e rekrutimit, kriteret dhe detyrimet e tyre.	Ministria gjatë vitit 2025 kishte hartuar Draft Rregulloren mirëpo e cila nuk ishte proceduar për miratim.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë evidenca me detaje të plota dhe të sakta lidhur me realizimin e kontratave, në mënyrë që furnizimet/shërbimet të jenë në përputhje me kushtet e kontraktuara.	Për vitin 2025, nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të sigurojë planifikim adekuat të shpenzimeve me buxhet, në mënyrë që shpenzimet të bëhet dhe regjistrohet në kodet ekonomike adekuate për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Për mostrat tona nuk kemi gjetur ndonjë keqklasifikim.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Ministrja duhet të siguroj kontrole dhe monitorim adekuat të procesit të subvencionimit, raportimit dhe përzgjedhjes së përfituesve vetëm pasi të janë plotësuar kriteret e përcaktuara duke siguruar se financimet publike arrijnë qëllimin e synuar.	Nga testimi i mostrave nuk ka rezultuar ndonjë parregullësi.	I zbatuar
5.	Detyrimet Kontigjente	Ministrja, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Edhe në vitin 2025 kemi nënvlerësim të detyrimeve kondingjente.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Arlinda Rahmani, Anëtare e ekipit



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ “Anëtarët e shërbimit të jashtëm”- janë anëtarët e përhershëm të Ministrisë si dhe anëtarët e Ministrisë të caktuar në misione diplomatike dhe konsullore në shtete të tjera dhe në organizata ndërkombëtare.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.